

На родителот може да му биде одземено вршењето на родителското право во поглед на сите деца или во поглед на некое од нив.

#### Член 177-к

Старателот на дете - жртва на трговија со луѓе е должен на центарот за социјална работа да доставува извештај за својата работа, еднаш неделно, како и тогаш кога тоа тој ќе го побара.

Од извештајот на старателот треба да се види неговата грижа за детето, потребите на детето, преземените дејствија, здравствената состојба на детето, предлози за подобрување на здравствената состојба, доколку тоа е потребно, контактите со другите органи доколку ги имало, проблемите со лицата кои го принудиле детето на ова дело и друго, од што може да се утврди комплетната состојба на детето и неговите потреби.

#### Член 177-л

Помошта на дете - жртва на трговија со луѓе и на семејството се дава без оглед на вера, раса, пол, национална припадност или социјално потекло, генетски карактеристики, јазик, религија, психички или физички способности, сексуална ориентација, возраст и друго.

#### Член 177-љ

Дејствијата кои ги преземаат и помошта која ја даваат центарот за социјална работа и старателот, заради заштита на детето - жртва на трговија со луѓе, секогаш треба да е прилагодена на возраста на детето и неговата зрелост да го сфати значењето на делото и да е во најдобар интерес на детето.

#### Член 177-м

Старателството над дете - жртва на трговија со луѓе престанува со враќање на детето во семејството, со смрт на старателот, смрт на детето - жртва на трговија со луѓе, по барање на старателот, родителите или по одлука на центарот за социјална работа."

#### Член 17

Во членот 279-а став 2 зборовите: "барањето од член 94-е" се заменуваат со зборовите: "предлогот од членот 94-д".

#### Член 18

Во членот 279-в ставови 1 и 2 зборот "барањето" се заменува со зборот "предлогот", а по зборот "работа" се додаваат зборовите: "односно на жртвата на семејното насилство".

#### Член 19

Во членот 279-д по зборот "трае" се додаваат зборовите: "најмалку три месеца, а "

#### Член 20

Во членот 279-ѓ по зборот "работа" се додаваат зборовите: "односно на жртвата на семејното насилство".

#### Член 21

Насловот на Главата V-б "Казнени одредби" се менува и гласи: "ПРЕКРШОЧНИ ОДРЕДБИ".

#### Член 22

Членот 279-з се менува и гласи:

„Глоба во износ од 500 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе се изрече за прекршок на физичко лице што нема да постапи согласно со обврските од членот 94-г став 3 на овој закон.

Глоба во износ од 3.000 до 5.000 евра во денарска противвредност ќе се изрече за прекршок и на правно лице што нема да постапи согласно со обврските од членот 94-г став 3 на овој закон.

Глоба во износ од 500 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе се изрече за прекршок и на одговорното лице во правното лице од ставот 2 на овој член.“

#### Член 23

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецистен текст на Законот за семејството.

#### Член 24

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

## L I G J PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR FAMILJEN

#### Neni 1

Në Ligjin për familjen ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 80/92, 9/96, 38/2004 dhe 33/2006) në nenin 1 fjalët: "marrëdhëniet e prishura dhe dhuna në jetën bashkëshortore dhe në familje" zëvendësohen me fjalët: "dhuna familjare" ndërsa në fund të fjalisë shtohen fjalët: "dhe procedura për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare".

#### Neni 2

Në nenin 4 paragrafi 2 ndryshohet si vijon:  
"Republika siguron mbrojtje nga dhuna familjare."

#### Neni 3

Në nenin 14, paragrafi 1 fjalët: "dhuna në jetën bashkëshortore dhe familje" zëvendësohen me fjalët: "dhuna familjare".

#### Neni 4

Në nenin 94 titulli i Kreut VI-a: "Marrëdhëniet e prishura dhe dhuna në jetën bashkëshortore dhe familje" zëvendësohet me: "Dhuna familjare"

#### Neni 5

Neni 94-a shlyhet.

#### Neni 6

Në nenin 94-b paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Me dhunë familjare nënkuptohet malltretimi, fyerja, rrezikimi i sigurisë, dëmtimi trupor, dhuna gjinore ose dhuna tjetër psikologjike ose fizike me të cilën nxitet ndjenja e pasigurisë, rrezikim ose frikë ndaj:

- bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve ose personave të tjerë të cilët jetojnë në bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose në amvisërinë e përbashkët,

- ish-bashkëshortit ose personave të cilët kanë fëmijë të përbashkët ose ndodhen në marrëdhënie të afërta personale, duke i përfshirë edhe marrëdhëniet që lindin me adoptim dhe kujdestari,

- vëllezërve dhe motrave, vëllezërve dhe motrave prej babait ose prej nënës,

- anëtarëve më të moshuar të familjes ose amvisërisë së përbashkët dhe

- personave – anëtarë të familjes ose të amvisërisë së përbashkët të cilët e kanë humbur aftësinë e punës pjesërisht ose tërësisht.

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3 si vijon:

“Me marrëdhënie të afërta personale në kuptimin e këtij ligji nënkuptohen marrëdhëniet personale ndërmjet personave me gjini të kundërt të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie partneriteti, ndërsa nuk jetojnë në bashkësi jashtëmartesore.”

Paragrafi 3 shlyhet.

#### Neni 7

Neni 94-v ndryshohet si vijon:

“Viktimitë e dhunës në familje mund të jetë cilido person nga neni 94-b i këtij ligji, pa marrë parasysh gjininë dhe moshën.

Kryerës i dhunës familjare mund të jetë cilido person nga neni 94-b i këtij ligji.”

#### Neni 8

Në nenin 94-g paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

“Qendra për punë sociale çdo herë kur është e njoftuar se ndaj personit është kryer dhunë familjare, vetë ose me kërkesë të personit ose anëtarit të familjes së tij, ndërmerr masa për mbrojtjen e viktimës së dhunës familjare.”

Në paragrafin 2 fjalët: “në familje” shlyhen.

Në paragrafin 4 numri “48” zëvendësohet me numrin “72”.

Në paragrafin 5 fjalët: “në familje” shlyhen.

Në paragrafin 5 pika 8 ndryshohet si vijon:

“8) ngrit procedurë para gjykatës kompetente dhe ndërmerr masa të cilat dalin nga marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve”

Pas paragrafit 5 shtohen dy paragrafë të rinj 6 dhe 7, si vijojnë:

“Shoqata e qytetarëve, e regjistruar për realizimin e qëllimeve dhe detyrave nga sfera e mbrojtjes sociale, vetë ose në bashkëpunim me qendrën për punë sociale, mund t'i ndërmarrë masat për mbrojtje të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni, përveç masave për mbrojtje të përcaktuara në pikat 8 dhe 9. Shoqata e qytetarëve është e detyruar për masat e ndërmarrja brenda 24 orëve ta njoftojë qendrën për punë sociale, kompetente sipas vendbanimit të personit - viktimë e dhunës familjare.

Qendra për punë sociale pas marrjes së njoftimit nga paragrafi 6 i këtij neni, në afat prej 24 orësh përgatit vendim përkatës. Shoqata e qytetarëve është e detyruar që në afat prej 72 orësh nga marrja e masave për mbrojtje, dokumentacionin e tërë t'ia dorëzojë qendrës për punë sociale për shkak të vëprimit të mëtejshëm.”

Paragrafi 6 shlyhet.

#### Neni 9

Në nenin 94-d para paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 1 si vijon:

“Viktima e dhunës familjare mund t'i paraqesë propozim për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje gjykatës kompetente drejtpërdrejtë ose përmes qendrës për punë sociale.”

Në paragrafin 1 i cili bëhet paragrafi 2 fjala “kërkesë” zëvendësohet me fjalën “propozim”.

Në paragrafin 2 i cili bëhet paragrafi 3 fjala “kërkesa” zëvendësohet me fjalën “propozim” ndërsa numri “1” zëvendësohet me numrin “2”.

#### Neni 10

Në nenin 94-gj fjala “kërkesa” zëvendësohet me fjalën “propozim”.

#### Neni 11

Në nenin 94-e fjalja hyrëse ndryshohet si vijon:

“Gjykata kompetente, kryerësit të dhunës familjare mund t'ia shqiptojë masat e përkohshme për mbrojtje si vijojnë:”.

#### Neni 12

Në nenin 94-zh, paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

“Propozimi për shqiptimin e masës së përkohshme mund të paraqitet pa marrë parasysh se a mbahet procedurë penale.”

Paragrafi 3 shlyhet.

#### Neni 13

Në nenin 94-z, paragrafi 1, pas fjalës: “zgjat” shtohen fjalët: “së paku tre muaj, ndërsa”.

#### Neni 14

Në nenin 94-i, në paragrafët 1 dhe 2 pas fjalëve: “qendra për punë sociale” shtohen fjalët: “gjegjësisht viktimia e dhunës familjare”.

#### Neni 15

Në nenin 124, pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3 si vijon:

“Republika siguron mbrojtjen edhe të personave të mitur- viktimia të trafikut me njerëz.”

#### Neni 16

Në nenin 177 shtohet Kreu i ri V-a “KUJDESTARIA MBI PERSONAT E MITUR-VIKTIMA TË TRAFIKUT ME NJERËZ” dhe 16 nene të reja: 177-a, 177-b, 177-v, 177-g, 177-d, 177-gj, 177-e, 177-zh, 177-z, 177-x, 177-i, 177-j, 177-k, 177-l, 177-ll dhe 177-m, si vijojnë:

#### “V-a

KUJDESTARIA MBI PERSONAT E MITUR-VIKTIMA TË TRAFIKUT ME NJERËZ

#### Neni 177-a

Fëmijë-viktimë e trafikut me njerëz është personi i mitur deri në moshën 18 vjeçare, i cili me ose pa pëlqimin e tij, në çfarëdo mënyre, është bërë viktimë e trafikut me njerëz me qëllim të eksploatimit.

Në rast të pasigurisë për moshën e viktimës dhe kur ekzistojnë shkaqe të besohet se ai është fëmijë, mendohet se është fëmijë dhe derisa pritet të konfirmohet moshja e tij, i shqiptohen masa për mbrojtje të cilat janë të parapara për fëmijët-viktimë të trafikut me njerëz.

#### Neni 177-b

Qendra për punë sociale çdo herë kur do të marrë njoftim nga Ministria e Punëve të Brendshme, se është identifikuar person i mitur-viktimë e tregtisë me njerëz, menjëherë merr masa për mbrojtjen e personit, të drejtave dhe interesave të fëmijës dhe e vendos nën kujdestari.

Për kujdestar të personit të mitur – viktimë e tregtisë me njerëz caktohet personi i cili është i përgatitur për punë me fëmijët-viktima të trafikut me njerëz.

#### Neni 177-v

Qendra për punë sociale, gjatë kryerjes së punëve të veta, është e detyruar:

- të bashkëpunojë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, prokurorin publik, kujdestarin, familjen, prindërit dhe organet tjera, drejtoritë, institucionet dhe personat të cilët mund t'i ndihmojnë në realizimin e interesit më të mirë të fëmijës,
- të bëjë vlerësimin e përshtatshmërisë së familjes,
- ta përcjellë sjelljen e fëmijës,
- t'i japë ndihmë profesionale familjes dhe fëmijës dhe
- t'i ndërmarrë të gjitha masat për të cilat vlerëson se janë me interes më të mirë për fëmijën.

## Neni 177-g

Kujdestari nga neni 177-b, paragrafi 2 i këtij ligji, gjatë kryerjes së punëve të veta bashkëpunon me: qendrën për punë sociale, Ministrinë e Punëve të Brendshme, prokurorin publik dhe institucione dhe drejtori të tjera relevante, të cilat janë kompetente për marrjen e veprimeve për mbrojtjen e personit, të drejtave dhe interesave të fëmijës.

## Neni 177-d

Kujdestari i personit të mitur-viktimë e trafikut me njerëz, është i detyruar të kujdeset si prind për personin, të drejtat dhe interesat e fëmijës nën kujdestari, e veçanërisht:

- ta ruajë fshehtësinë e identitetit të fëmijës dhe
- ta ruajë fshehtësinë e identitetit të familjes.

Kujdestari i fëmijës-viktimë e trafikut me njerëz, në mbrojtjen e fëmijës, është i detyruar:

- të sigurojë që fëmija të fitojë ndihmë mjekësore dhe psikosociale dhe mbrojtje,
- ta mbajë fëmijën pranë vendit të sigurtë për kujdes,
- të sigurojë për fëmijën ndihmë dhe mbrojtje të plotë juridike dhe me kohë,
- të nxjerrë dokumente personale për fëmijën,
- të sigurojë që fëmija t'i marrë të gjitha informatat në gjuhën e vet amëtare,
- të ndihmojë në procesin e gjetjes dhe kthimit të fëmijës në familje ose kthimin e fëmijës në vendin e origjinës,
- të ndërmarrë masa për vazhdimin e shkollimit,
- të jetë në kontakt të vazhdueshëm me qendrën për punë sociale,
- rregullisht të paraqesë raporte për veprimet e ndërmarrura dhe
- të ndërmarrë masa të tjera për mbrojtjen e personit, të drejtave dhe interesave të fëmijës, duke u shtyrë gjithmonë nga interesi më i mirë për fëmijën.

## Neni 177-gj

Kujdestari i fëmijës-viktimë e trafikut me njerëz, vetëm me miratimin e qendrës për punë sociale, krahas punëve nga neni 177-d të këtij ligji, mund:

- ta vendosë fëmijën te prindi tjetër, te personi tjetër ose në institucion,
- ta ndërrojë vendbanimin e fëmijës,
- ta kthejë në familjen amë,
- ta kthejë në shtetin amë,
- të sigurojë ndihmë sociale dhe psikosociale dhe
- të ndërmarrë veprime ose të marrë vendime, të cilat janë me rëndësi për jetën, shëndetin dhe personin e fëmijës.

## Neni 177-e

Fëmija-viktimë e trafikut me njerëz, pas moshës 15 vjeçare, i ka autorizimet e përcaktuara në nenin 162 të këtij ligji.

Për fëmijën-viktimë e trafikut me njerëz-i huaj në Republikën e Maqedonisë, lidhur me të drejtën e punësimit ose kryerjen e veprimtarisë së mëvetëshme, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Ligjit për punësim dhe punë me të huajt.

I mituri nga paragrafi 1 dhe nga paragrafi 2 i këtij ligji për çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjen për punësim dhe për çdo lëvizje, duhet ta njoftojë kujdestarin.

## Neni 177-zh

Nëse fëmija-viktimë e trafikut me njerëz është shtetas i Republikës së Maqedonisë dhe familja e tij jeton në territorin e Republikës së Maqedonisë, qendra për punë sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme, do ta gjejë familjen dhe do të bëjë vlerësimin e gjendjes së familjes, me qëllim të kthimit të fëmijës në familje.

Nëse fëmija viktimë e trafikut me njerëz është shtetas i huaj, qendra për punë sociale, në bashkëpunim me organet kompetente, do ta gjejë familjen dhe në konsultim me shërbimet

kompetente shtetas i të cilave është fëmija, do të ndërmarrë masa për mbrojtjen e fëmijës, të drejtave dhe interesave të fëmijës dhe do ta përgatisë fëmijën për kthim në shtet.

## Neni 177-z

Nëse në bazë të vlerësimit nga paragrafi 1 i nenit 177-zh, qendra për punë sociale, vlerëson se kthimi i fëmijës në familje, nuk e rrezikon shëndetin dhe jetën e fëmijës dhe e njëjta është në interes më të mirë për fëmijën, menjëherë do ta kthejë fëmijën në familje.

Nëse në bazë të vlerësimit nga paragrafi 1 i nenit 177-zh, qendra për punë sociale, vlerëson që kthimi i fëmijës në familje, e rrezikon shëndetin dhe jetën e fëmijës ose të familjes së tij, gjegjësisht që kthimi i fëmijës nuk është në interes më të mirë për fëmijën, do të gjejë strehim tjetër të përkohshëm.

Nëse për shkak të mosgjetjes së familjes, vdekjes së prindërve, kycjen e prindërve në veprën penale trafik me njerëz, ose për çfarëdo shkaqesh, nuk është e mundur kthimi i fëmijës në familjen e vet, qendra për punë sociale është e detyruar që menjëherë të kujdeset për fëmijën.

Strehimi nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni zgjat derisa të mënjanohen shkaqet për të cilat fëmija nuk është kthyer në familje, gjegjësisht, derisa të gjenden prindërit e fëmijës ose farefisi i tij që do të dojë të kujdeset për të, ose derisa të konfirmohet se prindërit nuk janë të përzier në veprën penale.

Pas mënjanimit të shkaqeve nga paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, fëmija menjëherë kthehet në familje.

## Neni 177-x

Qendra për punë sociale, çdo herë kur është e njoftuar se ekziston rreziku i kycjes së fëmijës në trafikun me njerëz ose në lloj tjetër të punës së dhunshme, derisa gjendet në familje, me detyrë zyrtare, do të marrë aktvendim për mbikëqyrjen e kryerjes së të drejtës prindërore në lidhje me të gjithë fëmijët ose në lidhje vetëm me ndonjërin prej tyre.

Qendra për punë sociale, do të marrë aktvendim për mbikëqyrjen e vazhdueshme të kryerjes të së drejtës prindërore, me detyrë zyrtare dhe në rastet kur fëmija-viktimë e trafikut me njerëz është kthyer në familjen amë.

Kohëzgjatja e mbikëqyrjes së kryerjes të së drejtës prindërore nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, do të zgjasë derisa të zgjasin shkaqet nga të cilat i njëjti është përcaktuar, por jo më gjatë se një vit.

## Neni 177-i

Qendra për punë sociale, nëse është e njoftuar se prindërit kanë marrë pjesë në kycjen e fëmijës në trafikun me njerëz ose në lloj tjetër të punës së dhunshme me aktvendim do ta marrë fëmijën nga prindi ose nga prindërit dhe do t'ia besojë për ruajtje dhe edukim prindit tjetër, personit ose institucionit tjetër.

## Neni 177-j

Prindit, i cili në çfarëdo mënyre ka marrë pjesë në kycjen e fëmijës në trafikun me njerëz ose në lloj tjetër të punës së dhunshme, pas marrjes së mendimit nga qendra për punë sociale, i merret kryerja e së të drejtës prindërore me aktvendim të gjyqit, në procedurë jashtëprocedurale.

Prindit mund t'i merret kryerja e së drejtës prindërore në lidhje me të gjithë fëmijët ose në lidhje me ndonjërin prej tyre.

## Neni 177-k

Kujdestari i fëmijës-viktimë e trafikut me njerëz, është i detyruar që qendrës për punë sociale t'i paraqesë raport për punën e vet, njëherë në javë, si dhe atëherë kur ai do ta kërkojë këtë.

Nga raporti i kujdestarit duhet të shihet kujdesi i tij për fëmijën, nevojat e fëmijës, veprimet e ndërmarrura, gjendja shëndetësore e fëmijës, propozimet për përmirësimin e gjendjes shëndetësore, nëse kjo është e nevojshme,

kontaktet me organet e tjera nëse i ka pasur, problemet me personat të cilët e kanë detyruar fëmijën në këtë vepër dhe të tjera, nga çka mund të vërtetohet gjendja komplete e fëmijës dhe nevojat e tij.

Neni 177-I

Ndihma ndaj fëmijës-viktimë e trafikut me njerëz dhe familjes, jepet pa marrë parasysh besimin, racën, gjininë, përkatësinë kombëtare ose origjinën sociale, karakteristikat gjenetike, gjuhën, religjionin, aftësitë psikike ose fizike, orientimin seksual, moshën etj.

Neni 177-II

Veprimet të cilat i ndërmarrin dhe ndihma të cilën e japin qendra për punë sociale dhe kujdestari, për mbrojtjen e fëmijës-viktimë të trafikut me njerëz, çdo herë duhet t'i përshtaten moshës së fëmijës dhe pjekurisë së tij që ta kuptojë rëndësinë e veprës dhe të jetë në interes më të mirë të fëmijës.

Neni 177-m

Kujdestaria ndaj fëmijës-viktimë e trafikut me njerëz, pushon me kthimin e fëmijës në familje, me vdekjen e kujdestarit, vdekjen e fëmijës-viktimë e trafikut me njerëz, me kërkesën e kujdestarit, prindërve ose me vendimin e qendrës për punë sociale."

Neni 17

Në nenin 279-a, paragrafi 2 fjalët: "kërkesa nga neni 94-e" zëvendësohen me fjalët: "propozimi nga neni 94-d".

Neni 18

Në nenin 279-v, paragrafët 1 dhe 2 fjala "kërkesa" zëvendësohet me fjalën "propozimi", ndërsa pas fjalës "punë" shtohen fjalët: "gjegjesisht të viktimës së dhunës familjare".

Neni 19

Në nenin 279 pas fjalës "zgjat" shtohen fjalët: "së paku tre muaj, ndërsa".

Neni 20

Në nenin 279-gj pas fjalës "puna" shtohen fjalët: "gjegjesisht të viktimës së dhunës familjare".

Neni 21

Titulli i Kreut V-b që është "Dispozita ndëshkuese" ndryshohet si vijon: "DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE"

Neni 22

Neni 279-z ndryshohet si vijon:  
"Gjohë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit fizik i cili nuk do të veprojë në pajtim me obligimet nga neni 94-g, paragrafi 3 i këtij ligji.

Gjohë në shumë prej 3.000 deri në 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje edhe personit juridik i cili nuk do të veprojë në pajtim me obligimet nga neni 94-g, paragrafi 3 i këtij neni.

Gjohë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës te personi juridik nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 23

Autorizohet Komisioni juridiko-ligjdhënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për familjen.

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

1556.

Vrz основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

### У К А З ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ЗАДОЛЖИТЕЛНИ РЕЗЕРВИ НА НАФТА И НАФТЕНИ ДЕРИВАТИ

Се прогласува Законот за задолжителни резерви на нафта и нафтени деривати,  
што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 4 јули 2008 година.

Бр. 07-2698/1  
4 јули 2008 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Бранко Црвенковски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
**Трајко Вељаноски, с.р.**

### ЗАКОН ЗА ЗАДОЛЖИТЕЛНИ РЕЗЕРВИ НА НАФТА И НАФТЕНИ ДЕРИВАТИ

#### І. ОПШТИ ОДРЕДБИ

##### Член 1

Со овој закон се уредуваат формирањето, чувањето, обновувањето и користењето на задолжителните резерви на нафта и нафтени деривати, надлежностите на Дирекцијата за задолжителни резерви на нафта и нафтени деривати, и други прашања од значење за задолжителните резерви на нафта и нафтени деривати.

##### Член 2

(1) Задолжителните резерви на нафта и нафтени деривати (во натамошниот текст: задолжителни резерви) се формираат со цел обезбедување на услови за интервентно снабдување на пазарот со нафта и нафтени деривати, во случај на нарушување на енергетската сигурност на државата предизвикана од нарушувања во снабдувањето од поголеми размери.

(2) Формирањето, чувањето, обновувањето и користењето на задолжителни резерви од ставот (1) на овој член се однесува за:

- сурова нафта,
- сите видови моторни и авио бензини,
- сите видови дизел гориво и керозин,
- ЕЛ - масло за домаќинство,
- ТНГ и
- мазут.

##### Член 3

За вршење на управните, стручните и другите работи во врска со задолжителните резерви се основа Дирекцијата за задолжителни резерви на нафта и нафтени деривати (во натамошниот текст: Дирекцијата).

### ІІ. ФОРМИРАЊЕ, ЧУВАЊЕ, ОБНОВУВАЊЕ И КОРИСТЕЊЕ НА ЗАДОЛЖИТЕЛНИТЕ РЕЗЕРВИ

##### Член 4

(1) Формирање, чување и обновување на задолжителните резерви се врши врз основа на среднорочна и годишна програма.